



FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO TENNIS FEDERATION

Kosova Tennis Federation  
House of sports  
Agim Ramadani str,  
10000 Prishtina  
Kosovo  
T: +383 45 746 543  
[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com)

---

# **RREGULLORE NR. #12 PËR PUNËN E BORDIT TË FEDERATËS SË TENISIT TË KOSOVËS**

**2022, Prishtinë**



Në bazë të nenit 6, të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës, në mbledhjen e vetë të mbajtur më 17 Nëntor 2022 nxjerr:

## **RREGULLOREN**

### **MBI PUNËN E BORDIT TË FEDERATËS SË TENISIT TË KOSOVËS**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi i Rregullores**

Me këtë rregullore të punës, rregullohet mënyra e punës së Bordit të Federatës së Tenisit të Kosovës (në tekstin e mëtejme Bordit të FTK-së).

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga ana e Bordit të FTK-së dhe të gjithë mekanizmave tjerë të Bordit të FTK-së.

#### **Neni 3**

##### **Struktura Organizative e Bordit të FTK-së**

1. Bordi i FTK-së numëron shtatë (7) anëtarë:
  - 1.1. Kryetari i FTK-së;
  - 1.2. Dy (2) nënkryetarë të FTK-së;
  - 1.3. Katër (4) anëtarë të tjerë të FTK-së.



## Neni 4

### **Veprimtaria e Bordit të Federatës së Tenisit**

Bordi i FTK-së kryen këto punë:

- Propozon Statutin dhe aktet tjera të Kuvendit,
- Përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin përcjellës,
- Ekzekuton vendimet e Kuvendit,
- Aprovon listën e zyrtareve të ndeshjeve dhe rregulloret e brendshme të Federatës,
- Përpilon planin e punës dhe atë financiar të Federatës,
- Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
- Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm,
- Emëron dhe aprovon planprogramin e punës së Këshillit profesional,
- Emëron dhe shkarkon trajnerët e reprezentacioneve,
- Emëron dhe shkarkon Komisararin e garave,
- Zgjedh dhe shkarkon Komisionin Disciplinor
- Aprovon raportet e Këshillave dhe Komisioneve të Bordit,
- Miraton sistemin e garave, kalendarin dhe propozicionet e garave,
- Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
- Cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kuotizimeve për anëtarët e Federatës,
- Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të ndeshjeve,
- Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
- Emëron dhe shkarkon anëtarët nga Këshillat dhe Komisionet e Bordit,
- Aprovon pjesëmarrjen e reprezentacioneve sipas kalendarit të ITF/ETF;
- Vendos për vendin e Kampionatit Ekipor, varësisht kërkesës së klubeve ose sponsorëve;
- Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

## Neni 5

### **Kuorumi, mbledhjet dhe vendimmarrja në Bordin e FTK-së**

5.1. Mbledhjet e Bordit i thërret Kryetari, e në mungesë të tij njëri prej nënkryetarëve ose Sekretari i përgjithshëm. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit.

5.2. Punimet e mbledhjes së Bordit udhëhiqen Kryetari i FTK-së. Në mungesë të Kryetarit, punimet e Bordit mund t'i udhëheqë njëri nga nënkryetarët, apo në mungesë të tyre Sekretari i përgjithshëm.

5.3. Mbledhjet e Bordit thiren me dërgimin e ftesës tek të gjithë anëtarët, jo më vonë se dy ditë para mbajtjes së saj.

5.4. Bordi mban mbledhje së paku një herë në çdo tre muaj. Kuorumi plotësohet kur në mbledhje marrin pjesë së paku katër (4) anëtarë të Bordit.



- 5.5. Bordi mund të vazhdoj me pikat e rendit të ditës, nëse prezent janë shumica e anëtarëve 50%+1
- 5.6. Bordi mund të mban mbledhjet edhe në formë elektronike (online), nëse për këtë pajtohen shumica e anëtarëve të Bordit të FTK-së.
- 5.7. Bordi vendimet e veta i merr me shumicë votash, në mbledhje të cilet janë organizuar në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme, Statutin e FTK-së dhe këtë Rregullore të Punës së Bordit. Në rast se një propozim merr vota të barabarta për dhe kundër, vota e Kryetarit të Bordit do të konsiderohet përcaktuese.

## **Neni 6**

### **Procesverbali i mbledhjes**

- 6.1. Në mbledhjet e Bordit mbahet procesverbali apo edhe mund të inçizohet.
- 6.2. Procesverbali mbahet apo inçizohet nga sekretari i përgjithshëm i FTK-së, në mungesë të tij Bordi zgjedhë njërin nga anëtarët e vetë.
- 6.3. Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai.
- 6.4. Procesverbalin e nënshkruan Procesmbajtësi dhe Kryetari.
- 6.5. Procesverbali aprovohet në mbledhjen e radhës.

## **Neni 7**

### **Rendi i ditës dhe thirrja e mbledhjes së Bordit**

- 7.1. Propozimin e Rendit të ditës për mbledhjet e Bordit e përcakton Kryetari i FTK-së.
- 7.2. Anëtarët e Bordit kanë të drejtën e propozimit për plotësim të rendit të ditës në mënyrë pikën e propozuar për trajtim e parashtrohet me shkrim së paku 24 orë para mbledhjes.
- 7.3. Thirrja dhe rendi i ditës për mbledhje dërgohen së bashku me procesverbalin nga mbledhja e kaluar së paku 24 orë para mbledhjes.

## **Neni 8**

### **Konfirmimi dhe pjesëmarrja**

- 8.1. Secili anëtar i Bordit është i obliguar që të konfirmoj ardhjen apo mosardhjen në mbledhje.
- 8.2. Pjesëmarrja në mbledhje është e obliguar për të gjithë anëtarët, përveç në rastet me arsye të caktuar.
- 8.3. Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, ai ka për obligim që ta njoftoi



Kryetarin ose Sekretarin e Përgjithshëm.

8.4. Në rast të mungesave pa arsye zbatohet dispozita e paraparë në statut të FTK-së.

## Neni 9

### Kryesimi i mbledhjes

9.1. Kryetari udhëheq me punën e Bordit, jep dhe merr fjalën, propozon Rendin e ditës, kujdeset për rendin dhe zbatimin e Rregullores së punës, tërheq vërejtjen për tejkalimin e kohës së diskutimit dhe daljes nga rendi i ditës.

9.2. Në rast të mungesës së kryetarit, mbledhja udhëhiqet nga njëri prej nënkryetarëve apo Sekretarit të Përgjithshëm.

9.3. Për secilën pike të rendit të ditës bëhet shqyrtim i veçantë dhe sipas radhitjes së miratuar.

## Neni 10

### Diskutimi në mbledhje

10.1. Secili anëtar i Bordit të FTK-së, ka të drejtë të diskutoj një herë për secilën pikë të rendit të ditës, pasi të i jepet fjala nga kryesuesi.

10.2. Bordi i FTK-së mund të vendos sipas propozimit të kryesuesit që koha e diskutimit të kufizohet.

10.3. Anëtari i Bordit ka të drejtë në replikë, nëse drejtpërdrejtë është përmendur apo në një mënyrë tjetër është kundërshtuar qëndrimi i tij, por ajo replikë nuk mund të jetë më e gjatë se 5 minuta.

## Neni 11

### Mbështetja administrativo-teknike

Mbështetje administrativo-teknike për nevojat e mbledhjes së Bordit, ofrohen nga Sekretari i përgjithshëm së bashku me stafin administrativ të FTK-së .




## Neni 12

### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të FTK-së.

Kryetari i FTK-së  
Jeton Hadërgjonaj



17 Nëntor 2022